



-III- Nr. I prot. 606 Më 05.03.2025
Br. prot. Dt. 25
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet lidhur me nenin 12 dhe 22 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit, bënë këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përmes kësaj shkrese ju bënë thirrje publike për aplikim të gjitha bizneseve që merren me grumbullimin dhe përpunimin e perimeve, të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë brenda territorit të Komunës së Rahovecit dhe që kanë përvojë dhe bashkëpunim të mirë me fermer kultivues të Trangullit Kornishan dhe që kanë të siguruar treg për shitjen e këtij produkti, të aplikojnë për të bashkëpunuar me komunën e Rahovecit për të i ndihmuar bujqit kultivues të trangullit në hapsira të mbrojtura - Serra:

Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për bizneset që merren me grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore - Trangullit, të cilat veprojnë në Komunën e Rahovecit dhe të cilat kanë përvojë në këtë veprimtari, të cilat kanë për qëllim lehtësimin e punës së kultivuesve të trangullit duke investuar në:

- Sigurimin e farës së trangullit
- Mbjellja dhe përgatitja e fidanit
- Plehrimi dhe Ri-plehrimi (kristaloret)
- Mulqerimi (folia e zezë)
- Sistemi i Ujitjes Pikë-Pikë (për vitin 2025)
- Shporta për vjelje
- Sesione informuese dhe përcjellje e vazhdueshme prej mbjelljes deri në vjelje

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 64,000.00 Euro

Specifikat tjera të thirrjes publike

- **Thirrja publike për aplikim hapet më 05.03.2025 dhe mbyllet më 20.03.2025.**
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen.
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DBPZHR.

- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i donacionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me biznesin që do të jetë përfitues i subvencionit do të nënshkruhet një kontratë

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit

- Projekt-propozimi, duke përfshirë specifikacion të qartë të shpenzimeve të nevojshme për kultivim të kësaj kulture,
- Certifikata me numër të regjistrimit të biznesit,
- Kopja e kartelës së xhirollogarorisë në emrin të biznesit dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar,
- Vërtetimi i ATK për shlyerje të obligimeve
- Dëshmia se ka përvojë në realizimin e projekteve duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën (kontrata me fermer, lista e fermerëve etj)

Kriteret e përzgjedhjes

- Licenca nga Agjencioni i Veterines dhe Ushqimit;
- Numri i fermerëve të kontraktuar sipas kulturave bujqesore në 3 vitet e kaluara (lista e fermerëve);
- Kontrata me partner ndërkombetare për exportimin e prodhimeve bujqesore vendore;
- Kontrata për furnizimin e perpunuesve vendor;
- Dëshmi të exportimit të produkteve bujqesore vendore në tregun e BE-së (DUD, CMR, etj në 3 vitet e kaluara.);
- Numri i punëtorëve (min. 5 punëtor, të dëshmohet me deklarime në ATK).

Mënyra e aplikimit

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen një kopje e të gjitha dokumentacionit original të kërkuara
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimit në katin e parë në objektin e Komunës.

